LIGJ
Nr.7573, datë 16.6.1992

PËR ZGJEDHJET E ORGANEVE TË PUSHTETIT LOKAL

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Organet e pushtetit lokal zgjidhen me votim të përgjithshëm, të drejtpërdrejtë, të fshehtë dhe të lirë.

Zgjedhja e këshillave lokale bëhet me sistem proporcional në zona me listë shumemërore. Kryetarët e komunave dhe të bashkive zgjidhen me sistem mazhoritar në zona me lista njëemërore.

Neni 2

Kanë të drejtën e votës shtetasit shqiptarë që ditën e zgjedhjeve kanë mbushur moshën 18 vjeç.

E drejta e votës mund të ushtrohet vetëm në territorin e komunës, të bashkisë ose të rrethit, ku zgjedhësi ka vendbanimin e tij të përhershëm ose të përkohshëm.

Neni 3

Shtetasit që gëzojnë të drejtën e votës kanë të drejtë të zgjidhen anëtarë të këshillave lokale ose kryetarë komune apo bashkie.

Neni 4

Përjashtohen nga e drejta e votës:

a) personat e paaftë mendërisht të cilësuar si të tillë nga gjykata;

b) personat të cilëve u është hequr e drejta elektorale me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Neni 5

Përjashtohen nga e drejta për t'u zgjedhur pjesëtarët e forcave të armatosura, gjyqtarët, prokurorët dhe hetuesit.

Neni 6

Kandidaturat e anëtarëve të këshillave lokale e të kryetarëve të komunave dhe të bashkive paraqiten nga subjektet elektorale, që janë partitë, grupimet e partive dhe kandidatët e pavarur.

Një person mund të paraqitet kandidat vetëm për një organ të pushtetit lokal.

Neni 7

Data e zgjedhjeve caktohet nga Presidenti i Republikës, të paktën 35 ditë përpara ditës së

zgjedhjeve.

KREU II
ORGANIZIMI I ZGJEDHJEVE PËR KËSHILLAT LOKALE DHE KRYETARËT E KOMUNAVE E TË BASHKIVE

Zonat e zgjedhjeve
Neni 8

Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal në çdo komunë,bashki dhe rreth krijohet përkatësisht një zonë zgjedhjeje.

Lista e zgjedhjeve
Neni 9

Zgjedhjet për organet e pushtetit lokal bëhen në bazë të listave të zgjedhësve.

Në listat e zgjedhësve regjistrohen të gjithë shtetasit që gëzojnë të drejtën e votës dhe kanë banim të përhershëm ose të përkohshëm në zonën ku zhvillohen zgjedhjet.

Neni 10

Listat e zgjedhësve hartohen për çdo qendër votimi nga organet ekzekutive të pushtetit lokal përkatës. Ato duhet të përmbajnë: emrin, atësinë, mbiemrin dhe datëlindjen e zgjedhësit, si dhe numrin e qendrës së votimit dhe zonën e zgjedhjeve.

Listat e zgjedhësve nënshkruhen nga kryetari dhe sekretari i organit ekzekutiv të pushtetit lokal përkatës.

Neni 11

Një zgjedhës regjistrohet vetëm në një listë zgjedhjeje.

Organi kompetent, sipas këtij ligji, për hartimin e listave të zgjedhësve, kur regjistrohen zgjedhës me banim të përkohshëm në territorin e tij, është i detyruar të njoftojë organin përkatës të vendbanimit të përhershëm të tyre, me qëllim që këta të mos regjistrohen në dy vende.

Neni 12

Listat e zgjedhësve shpallen në vende publike nga organi që i ka hartuar, jo më vonë se 15 ditë përpara ditës së zgjedhjeve.

Neni 13

Për zgjedhësit që shërbejnë dhe banojnë në njësitë e repartet ushtarake, listat e zgjedhësve hartohen dhe shpallen jo më vonë se 15 ditë përpara ditës së zgjedhjeve nga organet ekzekutive të pushtetit lokal më të afërt, në bashkëpunim me komandat e njësive dhe të reparteve ushtarake.

Të gjithë ushtarakët e tjerë regjistrohen në listat e zgjedhësve të vendbanimit të tyre.

Neni 14

Në spitalet, sanatoriumet dhe institucionet e tjera shëndetësore e riaftësuese, në kampet e riedukimit dhe në vendet e paraburgimit listat e zgjedhësve përgatiten nga drejtuesit e institucioneve, të kampeve të riedukimit dhe të vendeve të paraburgimit mbi bazën e dokumentit identifikues të të zgjedhësve. Drejtuesit e tyre detyrohen të njoftojnë organin kompetent të pushtetit lokal të vendbanimit të këtyre zgjedhësve, për të bërë ndryshimet në listat e zgjedhësve ku ata fillimisht janë regjistruar.

Neni 15

Kur një zgjedhës caktohet anëtar i komisionit të zgjedhjeve ose vëzhgues në një zonë apo qendër votimi dhe, për këtë shkak, do të largohet nga vendbanimi pas shpalljes së listës së zgjedhësve dhe para ditës së zgjedhjeve, me kërkesën me shkrim të subjektit elektoral, komisioni i zgjedhjeve të komunës ose bashkisë i lëshon një certifikatë për të votuar në vendin ku do të shkojë dhe në listën e zgjedhësve shënon fjalën "larguar". Ky zgjedhës regjistrohet në listën shtesë të zgjedhësve të qendrës së votimit të vendit ku do të shkojë, me të paraqitur certifikatën e të drejtës së votës, bashkë me letërnjoftimin ose ndonjë dokument tjetër që e zëvendëson atë.

Neni 16

Organi që ka shpallur listat e zgjedhësve, me vendim mund të bëjë ndryshime në këto lista, por jo më vonë se 48 orë para fillimit të votimit, kur një shtetas ka vdekur, është regjistruar dy herë, nuk figuron i regjistruar, nuk gëzon të drejtën e zgjedhjes ose ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 17

Çdo votues ka të drejtë të bëjë kërkesë me shkrim duke u paraqitur edhe vetë, për ndreqjen e gabimeve e të mangësive në listat e zgjedhësve si mosregjistrim, heqje nga lista, ndryshime në emër, atësi ose mbiemër, regjistrimi i personave që kanë humbur të drejtën e zgjedhjes etj. Kërkesa bëhet në organin që ka shpallur listat, i cili detyrohet ta shqyrtojë atë brenda dy ditëve dhe të japë vendim të argumentuar.

Kundër vendimit mund të bëhet ankim në gjykatën e shkallës së parë, në juridiksionin e së cilës përfshihet zona e zgjedhjeve.kata brenda 3 ditëve, në prani të ankuesit dhe të përfaqësuesit të organit që ka shpallur listat, shqyrton ankimin në seancë gjyqësore me dyer të hapura dhe merr vendimin përkatës. Vendimi i gjykatës është i formës së prerë.

Çdo ndryshim që bëhet në listat e zgjedhësve, shpallet menjëherë.

Neni 18

Listat e zgjedhësve vihen në dispozocion të subjekteve elektorale nga organet që i kanë shpallur, mbi bazën e kërkesës dhe kundrejt pagesës.

Qendrat e votimit

Neni 19

Votimi dhe numri i votave bëhet në qendrat e votimit.

Neni 20

Në fshatrat, për çdo 100 deri në 800 zgjedhës ngrihet një qendër votimi.

Në qytete për 800-1000 zgjedhës ngrihet një qendër votimi.

Për qytetet që kanë më pak se 800 zgjedhës ngrihet qendër votimi e veçantë. Për mbetjet më të mëdha se 400 zgjedhës krijohet qendër votimi e veçantë, ndërsa mbetjet më të vogla i bashkohen qendrës së votimit më të afërt të zonës së komunës ose bashkisë.

Kur një qendër banimi është larg nga qendra më e afërt e votimit më shumë se 3 km, aty ngrihet qendër votimi e veçantë, në qoftë se ka së paku 50 zgjedhës.

Neni 21

Qendrat e votimit caktohen jo më vonë se 20 ditë para ditës së zgjedhjeve.

Qendrat e votimit krijohen me vendim të organeve përkatëse ekzekutive të pushtetit lokal.

Neni 22

Në spitale, sanatoriume, shtëpi lindjeje dhe institucione të tjera si këto, në kampe riedukimi e vende paraburgimi ngrihen qendra votimi, në qoftë se kanë më shumë se 15 zgjedhës.

Në institucionet shëndetësore që kanë shumë pavione, mund të ngrihet një qendër votimi e veçantë për çdo pavion, në qoftë se secili prej tyre ka më shumë se 15 zgjedhës.

Komisionet e zgjedhjeve

Neni 23

Për organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve krijohen:

a) komisionet e zgjedhjeve të komunave, bashkive dhe rretheve;

b) komisioni i qendrës së votimit;

c) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Neni 24

Komisionet e zgjedhjeve përbehen nga 1 kryetar, 1 zëvendëskryetar, një sekretar, i cili si rregull të jetë jurist dhe nga një përfaqësues i çdo partie politike që ka paraqitur kandidat.

Kur numri i përgjithshëm i komisionit del çift shtohet një anëtar pa parti.

Komisionet e zgjedhjeve miratohen nga komiteti ekzekutiv i rrethit, me propozimin e partive politike që kanë paraqitur kandidatë.

Neni 25

Komisioni i zgjedhjeve kryen këto detyra:

a) kujdeset për zbatimin e përpiktë dhe të njëllojtë të këtij ligji gjatë zhvillimit të zgjedhjeve.

b) Ushtron kontroll mbi veprimtarinë e komisioneve të qendrave të votimit gjate zhvillimit të zgjedhjeve.

c) Mbikëqyr hartimin dhe shpalljen në afatet e caktuara me ligj të listave të zgjedhësve, si dhe përgatitjen në kohë të qendrave të votimit.

ç) Regjistron kandidatët dhe listat shumemërore të subjekteve elektorale, si dhe kandidatët e pavarur për organet e pushtetit lokal.

d) Pajis komisionet e qendrave të votimit me kuti votimi, zarfe, fletëvotimi, procesverbale dhe materiale të tjera të nevojshme për zhvillimin e zgjedhjeve.

dh) Ushtron kontroll për ruajtjen, shpërndarjen dhe transportimin e këtyre materialeve.

e) Numëron votat në mbështetje të procesverbaleve të qendrave të votimit dhe shpall përfundimet e zgjedhjeve në zonë. U lëshon vërtetimin e zgjedhjes këshilltarëve dhe kryetarëve të komunave e bashkive.

ë) Shqyrton ankimet kundër akteve dhe veprimeve të paligjshme ose të parregullta të komisioneve të qendrave të votimit për kandidatët e organit përkatës të pushtetit lokal.

f) Organizon votimin e raundit të dytë kur del e nevojshme.

g) I dorëzon komisionit të zgjedhjeve të rrethit aktet e zgjedhjeve që përmenden në këtë ligj.

Komisionet e zgjedhjeve të komunave dhe bashkive lëshojnë çertifikata për të drejtë vote për rastet e caktuara në këtë ligj.

Neni 26

Për çdo qendër votimi ngrihet komisioni i qendrës së votimiti përbërë nga kryetari, sekretari dhe nga një përfaqësues të sub-jekteve elektorale që kanë paraqitur kandidatë. Kur numri i përgjithshëm del çift, shtohet një anëtar pa parti.

Komisioni i qendrës së votimit miratohet nga komisioni i zgjedhjeve të komunës ose i bashkisë, me propozim të partive politike,që kanë paraqitur kandidatë, jo më vonë se 20 ditë përpara

ditës së zgjedhjeve.

Neni 27

Komisioni i qendrës së votimit kryen këto detyra:

a) Siguron zhvillimin e lirë dhe të qetë të zgjedhjeve në qendrën e votimit në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë ligj.

b) Siguron mbajtjen e rregullit gjatë votimit.

c) Numëron votat e hedhura për çdo subjekt ose kandidat të pavarur për anëtarët e këshillit të komunës, bashkisë dhe rrethit.

ç) Numëron votat e hedhura për çdo kandidat për kryetarkomune ose bashkie.

d) Përgatit dhe i dorëzon komisionit të zgjedhjeve të komunës ose të bashkisë dhe të rrethit proçesverbalin e votimit.

dh) Regjistron në procesverbal ankesat dhe kërkesat e anëtarëve të komisionit, të zgjedhësve dhe të kandidatëve, i shqyrton ato dhe merr vendimin përkatës.

e) Ju dërgon komisioneve të zgjedhjeve aktet e që përcakton ky ligj.

Neni 28

Udhëzimet e kryetarit të komisionit të qendrës së votimit në kohën e zgjedhjeve janë të detyrueshme për të gjithë shtetasit që ndodhen në qendrën e votimit. Këto udhëzime mund të anullohen vetëm me vendim të komisionit të qendrës së votimit.

Neni 29

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari, sekretari dhe 14 anëtarë.

Përbërja e Komisionit Qendror vendoset nga Presidenti i Republikës, me propozimin e partive politike, jo më vonë se 30 ditë përpara ditës së zgjedhjeve.

Partitë politike që nuk kanë anëtarë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve si dhe shoqatat e specializuara për vëzhgimin e zgjedhjeve kanë të drejtë të dërgojnë vëzhgues.

Neni 30

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kryen këto detyra:

a) Kujdeset për zbatimin e përpiktë dhe të njëllojtë të këtij ligji gjatë zhvillimit të zgjedhjeve në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

b) Ushtron drejtimin metodologjik dhe kontrollon veprimtarinë e komisioneve të zgjedhjeve të rretheve, të bashkive e të komunave.

c) Shqyrton ankimet kundër akteve dhe veprimeve të paligjshme e të parregullta të komisioneve të zgjedhjeve.

ç) Ushtron kontroll për regjistrimin e listave të kandidatëve për anëtarë të këshillave lokale dhe të kandidatëve për kryetarë komunash ose bashkish.

d) Vendos rregulla për pjesëmarrjen në zgjedhje të vëzhguesve të brendshëm dhe të huaj dhe u jep atyre dokumentin identifikues.

dh) Kontrollon, kur është rasti, listat e zgjedhësve pas përfundimit të zgjedhjeve dhe kur gjen që një shtetas ka votuar më tepër se një herë, ia parashtron çështjen organit kompetent.

e) Njofton përfundimet e zgjedhjeve në shkallë kombëtare.

Neni 31

Anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve mund të lirohen nga detyra e tyre prej organit që ka miratuar përbërjen e komisionit, me kërkesën e vetë anëtarëve ose me propozim të subjekteve elektorale që përfaqësojnë.

Neni 32

Nuk mund të jenë anëtarë të komisioneve të zgjedhjeve anëtarët e organeve ekzekutive të pushtetit lokal, ushtarakët si dhe kandidatët për anëtarë të organeve të pushtetit lokal.

Neni 33

Komisionet e zgjedhjeve zhvillojnë mbledhje të vlefshme kur në to merr pjesë shumica e anëtarëve të tyre. Vendimet e komisioneve të mësipërme merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm.

Neni 34

Mbledhjet e komisioneve të zgjedhjeve janë publike. Në to mund të marrin pjesë edhe vëzhgues të autorizuar nga komisionet e zgjedhjeve brenda juridiksionit përkatës, të cilët kanë të drejtë të bëjnë vërejtje. Me kërkesën e tyre vërejtjet shënohen në procesverbalin e mbledhjes së komisionit.

Neni 35

Partitë politike kanë të drejtë të paraqesin një listë me emrat e personave për të zëvendësuar përfaqësuesit e tyre, të cilët bëjnë pjesë në komisionet e zgjedhjeve të komunave, të bashkive të rretheve, si dhe të qendrave të votimit. Kur këta të fundit janë të paaftë për të kryer funksionet, zëvendësimi i tyre bëhet nga organi që ka miratuar përbërjen.

Neni 36

Personat që marrin pjesë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve apo në komisionet e zgjedhjeve të komunave, të bashkive ose të rretheve shkëputen nga puna kundrejt pagesës që ditën e caktimit të tyre, ndërsa ata të komisioneve të qendrave të votimit kanë të drejtë të shkëputen nga puna kundrejt pagesës 3 ditë para votimit dhe 2 ditë pas votimit.

Shpërblimi i personave të mësipërm bëhet nga buxheti i shtetit, në masën e caktuar prej Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Masa e shpërblimit për anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve caktohet nga Presidenti i Republikës.

Neni 37

Në kuptimin e Kodit Penal, quhen "persona të ngarkuar me detyrë shtetërore" të gjithë personat që bëjnë pjesë në komisionet e zgjedhjeve gjatë ushtrimit të detyrës.

Neni 38

Anëtarët e komisionit të zgjedhjeve dhe vëzhguesit, gjatë përmbushjes së funksioneve të tyre, ndalohet të mbajnë shenja dalluese apo simbole të partisë ose të grupimit të cilit i përkasin dhe as të kryejnë ose të marrin pjesë në veprimtari propagandistike për zgjedhje.

Ankimet kundër vendimeve të komisioneve të zgjedhjeve

Neni 39

Vendimet e komisioneve të zgjedhjeve të komunave, bashkive dhe rretheve mund të ankimohen në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, brenda 3 ditëve nga shpallja e tyre.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shqyrton ankimet dhe brenda 3 ditëve merr vendimin përkatës.

Neni 40

Kundër vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve mund tëbëhet ankim në Gjykatën e Kasacionit brenda 3 ditëve nga shpallja e tyre.

Gjykata e Kasacionit shqyrton ankimin dhe brenda 3 ditëve jep vendimin e formës së prerë.

Fushata e zgjedhjeve

Neni 41

Fushata e zgjedhjeve për organet e pushtetit lokal fillon me shpalljen e datës së zgjedhjeve dhe mbyllet 24 orë përpara kësaj date.

Neni 42

Gjatë fushatës së zgjedhjeve, çdo subjekt elektoral, si dhe shtetasit kanë të drejtë të bëjnë propagandë lirisht nëpërmjet mitingjeve, mbledhjeve, radios, televizionit, shtypit dhe mjeteve të tjera të informimit masiv.

Ndalohet çdo lloj propagande që zhvillohet në kundërshtim me ligjet, rendin juridik ose që prek dinjitetin personal të kandidatëve.

Publikimi i anketave lidhur me zgjedhjet ndërpritet 8 ditë përpara ditës së zgjedhjeve.

Neni 43

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve organizon në Radiotelevizionin Shqiptar emisione për edukimin elektoral të popullsisë, duke përjashtuar qëndrimet partiake.

Neni 44

Kandidatët, si edhe subjektet elektorale kanë të drejtë të përdorin materiale të ndryshme propagandistike si parulla, lajmërime,fletushka etj., në të cilat duhet të shënohet emri i subjektit elektoral që i përgatit këto materiale. Ndalohet dëmtimi i tyre deri në fund të fushatës.

Organet e pushtetit lokal sigurojnë mundësi të barabarta propagandistike për çdo subjekt elektoral.

Neni 45

Ndalohet zhvillimi i fushatës së zgjedhjeve në njësi dhe reparte ushtarake, si dhe në institucionet e depolitizuara.

Komandat e njësive e të reparteve ushtarake të lejojnë përdorimin e mjeteve të informimit masiv në kohën e lirë, si dhe pjesëmarrjen në fushatën elektorale brenda territorit të zonës së zgjedhjeve, jashtë njësive apo repartit.

Neni 46

Ndalohet zhvillimi i fushatës elektorale nga persona që nukkanë shtetësinë shqiptare.

Ndalohet shpifja dhe fyerja kundër kandidatit dhe subjektit elektoral.

Neni 47

Ndalohet shpifja dhe çrregullimi i mbledhjeve dhe i mitingjeve elektorale të ligjshme.

Neni 48

Organet e pushtetit lokal, si dhe çdo organ tjetër shtetëror nuk kanë të drejtë të shpërndajnë materiale propagandistike elektorale dhe as të marrin pjesë në propagandën që zhvillohet.

Neni 49

Këshilli i Minsitrave cakton shpenzimet e buxhetit për subjektet elektorale si vijon:

a) 30 për qind e shumës së caktuar shpërndahet ndërmjet subjekteve elektorale në përpjestim me kandidatet e regjistruar për anëtarë të këshillave lokale dhe kryetarë komunash ose bashkish.

b) 70 për qind e shumës së caktuar u ndahet partive në përpjestim me numrin e votave në shkallë kombëtare të fituara në zgjedhjet e mëparshme.

Në rast se subjekti elektoral nuk fiton mbi 3% të votave tëzonave elektorale ku ka konkuruar, detyrohet t'i kthejë shtetitshumën e financuar.

Ngarkohet Ministria e Financave të nxjerrë rregullat e financimit, të përdorimit dhe të kontrollit të fondeve të akorduara.

Neni 50

Kandidatëve për anëtarë të këshillave lokale dhe kryetarë komunash ose bashkish, gjatë fushatës së zgjedhjeve, kur shkëputen nga puna, u ruhet vendi i punës dhe u jepet pagë e plotë.

Kandidaturat

Neni 51

Numri i anëtarëve të këshillave të komunave, të bashkive dhetë rretheve caktohet:

- Për komunat ose bashkitë me popullsi deri në 10 mijë banorë,11-13 këshilltarë.
- Për komunat ose bashkitë me popullsi nga 10-20 mijë banorë,13-15 këshilltarë.
- Për komunat ose bashkitë me popullsi nga 20-50 mijë banorë,15-17 këshilltarë.
- Për komunat ose bashkitë me popullsi mbi 50 mijë banorë, 17-21 këshilltarë.
- Për rrethet me popullsi deri 150 mijë banorë, 23-27 këshilltarë.
- Për rrethet me popullsi mbi 150 mijë banorë, nga 31-35 këshilltarë.
- Për bashkinë e Tiranës 35 këshilltarë.

Neni 52

Kërkesa për regjistrimin e kandidatëve për këshillat lokale,kryetarët e komunave dhe të bashkive bëhet në komisionin përkatës të zgjedhjeve, jo më vonë se 15 ditë përpara ditës së zgjedhjeve.

Neni 53

Regjistrimi i kandidatëve për kryetar të komunave ose bashkive bëhet mbi bazën e këtyre dokumentave:

a) Kërkesa me shkrim nga subjekti përkatës elektoral për regjistrimin e kandidatit, e cila duhet të përmbajë emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen e kandidatit dhe vendbanimin (2 kopje).

b) Deklarata e kandidatit që pranon vënien e kandidaturës së tij (2 kopje).

c) Deklarata e kandidatit për pasurinë e familjes së tij.

Neni 54

Regjistrimi i kandidatëve për anëtarë të këshillave të komunave, të bashkive dhe të rretheve bëhet mbi bazën e këtyre dokumentave:

a) Listat e kandidatëve të paraqitura nga subjektet elektorale, me nënshkrimin e drejtuesve të tyre; kjo listë duhet të përmbajë edhe të dhëna të tjera që parashikohen në gërmën "a" të nenit 53 të këtij ligji.

b) Deklarata e kandidatit që pranon vënien e kandidaturës së tij.

c) Deklarata e kandidatit për pasurinë e familjes së tij.

Listat e përbashkëta të disa subjekteve elektorale duhet të nënshkruhen bashkërisht nga drejtuesit e tyre.

Neni 55

Regjistrimi i kandidatëve të pavarur për kryetar komune dhe bashkie ose anëtar i këshillit të komunës, bashkisë ose rrethit bëhet mbi bazën e këtyre dokumentave:

a) Kërkesa e kandidatit (2 kopje) me të dhënat e pikës "a" të nenit 54.

b) Deklarata e kandidatit për pasurinë e familjes së tij.

c) Lista me nënshkrimet e zgjedhësve, të cilët përkrahin paraqitjen e kandidatit të pavarur. Kjo listë duhet të përmbajë 150 zgjedhës, duke shënuar emrin, atësinë, mbiemrin, serinë e numrit të letërnjoftimit dhe nënshkrimin e secilit. Këta zgjedhës duhet të banojnë në zonën ku kandidati paraqitet dhe lista e tyre të vërtetohet nga komisioni përkatës i zgjedhjeve.

Një zgjedhës nuk ka të drejtë të nënshkruajë në më shumë senjë listë. Listat depozitohen në komisionin përkatës të zgjedhjeve dhe mund të kontrollohen me autorizim të rregullt të tij.

Neni 56

Kur komisioni i zgjedhjeve të komunës, të bashkisë ose të rrethit vëren parregullsi në dokumentet për regjistrimin e kandidatëve, njofton subjektet elektorale ose kandidatët e pavarur për ndreqjen e tyre brenda 2 ditëve nga konstatimi. Në rast të kundërt, komisioni i zgjedhjeve të komunës, bashkisë ose rrethit merr vendimin përkatës.

Neni 57

Një person mund të vendosë kandidaturën e tij vetëm në një zonë.

Neni 58

Subjektet elektorale mund të paraqesin vetëm një listë të kandidatëve për këshillat e komunave, të bashkive e të rretheve dhe vetëm një kandidat për kryetar komune ose bashkie.

Neni 59

Komisonet e zgjedhjeve të komunave, të bashkive dhe të rretheve kur janë plotësuar kushtet e këtij ligji, detyrohen të regjistrojnë kandidatët e paraqitur me listë për anëtarë të këshillave lokale dhe kandidatët për kryetarë komunash ose bashkishë, si dhe të bëjnë shpalljen e tyre jo më vonë se 10 ditë përpara ditës së zgjedhjeve, duke shënuar edhe subjektin që i ka paraqitur ose kandidatin e pavarur. Ato u dërgojnë një kopje të vërtetimit të gjithë kandidateve të paraqitur.

Neni 60

Për çdo kandidat të paraqitur, komisioni i zgjedhjeve të komunës, të bashkisë ose të rrethit mban një procesverbal regjistrimi sipas formës së caktuar.

Neni 61

Kur një kandidat për anëtar keshilli lokal ose për kryetar komune apo bashkie hiqet nga subjekti propozues, tërheq kandidaturën e vet ose vdes mbasi është regjistruar nga komisioni përkatës i zgjedhjeve, subjekti elektoral mund të regjistrojë një kandidat tjetër, por jo më vonë se 7 ditë përpara ditës së zgjedhjeve.

Fletët e votimit

Neni 62

Modeli i fletës së votimit caktohet nga Këshilli i Ministrave.

Neni 63

Fleta e votimit për zgjedhjen e anëtarëve të këshillave lokale përmban subjektin elektoral që ka paraqitur listë kandidatësh e simbolin e tij, si dhe emrat e kandidatëve të pavarur.

Fleta e votimit për kryetarë të komunave ose bashkive përmban emrin, atësinë, dhe mbiemrin e kandidatit, si dhe subjektin elektoral që e ka paraqitur, së bashku me simbolin përkatës.

Neni 64

Fletët e votimit shtypen me të njëjtat përmasa, me ngjyrë të njëllojtë e përbërje të njëjtë të letrës, në numër kopjesh të barabarta me numrin e zgjedhësve të regjistruar në listat e zgjedhësve, plus pesë për qind.

KREU III
VOTIMI

Neni 65

Votimi për zgjedhjen e organeve të pushtetit lokal bëhet në mjedise të caktuara nga organet ekzekutive të pushtetit lokal. Në to nuk lejohet të ketë asnjë material propagandistik.

Ndalohet përdorimi si qendra votimi i godinave të partive politike dhe i institucioneve shtetërore të depolitizuara, me përjashtim të shkollave.

Neni 66

Votimi për zgjedhjen e organeve të pushtetit lokal bëhet në një ditë pushimi për të gjithë vendin.

Votimi fillon në orën 6 dhe mbyllet në orën 18. Në qoftë se pas orës 18 ka ende njerëz që presin të votojnë, votimi vazhdon deri sa të mbarojnë të gjithë të pranishmit.

Kryetari i komisionit të qendrës së votimit në orën 6 të ditës së votimit, në prani të më shumë se gjysmës së anëtarëve, deklaron fillimin e votimit.

Votimi fillon me kontrollin e kutive të votimit në praninë e komisionit dhe vëzhguesve. Pas kësaj kutitë mbyllen dhe vulosen me vulën e qendrës së votimit, e cila mbahet në ruajtje.

Kryetari i komisionit të qendrës së votimit, në prani të komisionit, vulos të gjitha fletët e votimit, numri i të cilave shënohet në procesverbalin që firmoset nga të gjithë anëtarët e pranishëm të komisionit.

Neni 67

Zgjedhësit votojnë sipas radhës së paraqitjes.

Çdo votues është i detyruar të vërtetojë identitetin e tij, duke paraqitur letërnjoftimin, librezën ushtarake ose çertifikatën e lëshuar posaçërisht për zgjedhjet, në çdo rast me fotografi të rregullt.

Ushtarakët nuk lejohet të paraqiten në qendrën e votimit si trup i rreshtuar dhe me armë. Lejohen të paraqiten me uniformë vetëm ushtarakët që janë në shërbim.

Pas verifikimit të të dhënave të dokumentit identifikues melistën e zgjedhësve, komisioni shënon numrin e dokumentit identifikues, zgjedhësi firmos, merr fletën e votimit dhe voton. Pas votimit, në faqen e fundit të dokumentit të identifikimit, vihet vula.

Kur konstatohet që fleta e votimit nuk është e rregullt, ajo veçohet, firmoset si e pavlefshme dhe zëvendësohet me një tjetër nga kryetari.

Neni 68

Në çdo qendër votimi detyrimisht ngrihet dhoma e fshehtësisë me një ose disa ndarje të

veçanta për të shpejtuar procesin e votimit. Në ndarjet e veçanta të dhomës së fshehtë ndalohet të ketë fletëvotimi.

Tryeza e komisionit të qendrës së votimit të vendoset në mënyrë të tillë që rreth saj të lëvizin anëtarët e komisionit dhe vëzhguesit që përfaqësojnë subjektet elektorale. Kutitë e votimit vendosen në një vend të dukshëm për të gjithë të pranishmit.

Në ndarjet e veçanta të dhomës së fshehtësisë ndalohet prania e ndonjë personi tjetër apo dhe anëtari të komisionit të qendrës së votimit, me përjashtim të rasteve kur votuesi nuk mund të kryejë vetë procedurën e domosdoshme të votimit dhe kërkon ndihmë nga një person i zgjedhur prej tij. Personi i zgjedhur ka të drejtë të shoqërojë vetëm një votues. Në këto raste, merret leje nga kryetari i komisionit të qendrës së votimit dhe kjo shënohet në listën e zgjedhësve.

Nuk lejohet kryerja e veprimeve mbi fletën e votimit jashtëndarjeve të veçanta të dhomës së fshehtësisë. Në rast të kundërt,vota quhet e pavlefshme dhe fletëvotimi griset nga komisioni pa uhedhur në kutinë e votimit, duke i dhënë zgjedhësit edhe një herë tjetër mundësinë për të votuar. Për fletëvotimet e grisura mbahet procesverbal.

Kur ka zgjedhës në ndarjet e dhomës së fshehtësisë ndalohet çdo person të jetë më afër se 3 metra nga ndarja.

Në qoftë se është e nevojshme për të vendosur rregull në qendrën e votimit, kryetari i komisionit të qendrës së votimit mund të kërkojë ndihmën e organeve të policisë.

Në qendrën e votimit ndalohet të futen persona të armatosur.

Subjektet elektorale kanë të drejtë të dërgojnë vëzhgues tëtyre në çdo qendër votimi, të cilët pajisen me autorizim të komisionit të zgjedhjeve të komunës, bashkisë ose të rrethit.

Neni 69

Fletëvotimi për zgjedhjen e këshillave lokale të komunës, bashkisë ose rrethit është i vlefshëm kur votuesi lë vetëm emrin e subjektit elektoral pro të cilit voton, duke fshirë me vizë emrat e subjekteve të tjerë.

Neni 70

Fletëvotimi për zgjedhjen e kryetarëve të komunave ose bashkive është i vlefshëm kur votuesi lë vetëm emrin e kandidatit duke fshirë me vizë emrat e kandidatëve të tjerë.

Neni 71

Të gjitha fletëvotimet e plotësuara gabim, të grisura, të dëmtuara ose të përdorura ruhen për inventarin kontrollues përfundimtar.

Neni 72

Kur ka shkelje të ligjit që pengojnë procesin e votimit, komisioni i qendrës së votimit mund të vendosë pezullimin e votimit,deri sa shkeljet të eliminohen. Ky vendim i bëhet i ditur menjëherë komisioneve përkatëse të zgjedhjeve.

KREU IV
NUMËRIMI I FLETËVE TË VOTIMIT DHE NXJERRJA E REZULTATIT TË VOTIMIT

Numërimi i fletëve të votimit

Neni 73

Menjëherë pasi përfundon votimi, kryetari i qendrës së votimit në prani të komisionit dhe të vëzhguesve të autorizuar:

a) deklaron votimin e përfunduar;

b) numëron zgjedhësit që kanë marrë pjesë në votim sipas listave të tyre, të cilat duhet të firmosen nga kryetari dhe sekretari i komisionit dhe nga çdo përfaqsues subjekti elektoral që dëshiron.

Listat vendosen në një zarf që vuloset me të njëjtën vulë të qendrës së votimit. Mbi zarf firmosin kryetari e sekretari i komisionit dhe përfaqësuesit e subjekteve që dëshirojnë. Zarfi dorëzohet në komisionin e zgjedhjeve të komunës ose bashkisë prej nga merret vërtetimi përkatës;

c) veçon të gjitha fletët e votimit të papërdorura, i numëron ato dhe vepron sipas mënyrës së treguar në paragrafin e dytë të gërmës "b".

Këto veprime duhet të kryhen sipas radhës së mësipërme, dukei shënuar në procesverbalin përfundimtar.

Neni 74

Pas kryerjes së veprimeve të mësipërme:

a) hapet kutia e votimit dhe njëri nga anëtarët e komisionit, i caktuar me short, nxjerr e shpalos një e nga një fletët evotimit dhe ia jep kryetarit, i cili deklaron me zë të lartë në se fleta e votimit është e vlefshme dhe cilit kandidat apo subjekt i takojnë votat. Këtë fletë ua jep ta shohin të gjithë anëtarët e komisionit, si dhe vëzhguesve të pranishëm. Vetëm pasi regjistrohen rezultatet dhe fleta vihet në vendin e caktuar, mund të nxirret një fletë tjetër votimi;

b) bëhet numërimi i fletëve të votimit të përdorura, të vlefshme dhe të pavlefshme;

c) verifikohet përputhja e shifrave të procesverbalit, duke përsëritur numërimin kur nevojitet.

Këto veprime kryhen sipas radhës së mësipërme, duke bërë shënimet në procesverbal.

Neni 75

Fletët e votimit janë të pavlefshme kur:

a) nuk del e qartë se për cilët kandidatë ose subjekt është dhënë vota;

b) nuk janë sipas kërkesave të formës, madhësisë, ngjyrës, përbërjes së letrës, përmbajtjes dhe vulosjes;

c) janë dëmtuar aq shumë, saqë nuk kuptohet çfarë shprehet në to;

d) janë lënë pa u fshirë më shumë se një kandidat ose subjekt apo janë fshirë të gjithë kandidatët ose subjektet;

e) janë shtuar emra ose subjekte të tjerë.

Vlerësimi i votës bëhet nga komisioni i qendrës së votimit. Votat e diskutueshme fillimisht shqyrtohen dhe pastaj vlerësohen. Çdo kundërshtim nga anëtarët e komisionit shënohet në procesverbal dhe këto fletë votimi ruhen veçmas.

Neni 76

Në përfundimin e votimit, numërimit dhe vlerësimit të fletëve të votimit, kryetari i komisionit të qendrës së votimit harton detyrimisht tri procesverbale: një për këshilltarët e komunës ose të bashkisë, një për kryetarin e komunës ose bashkisë dhe një për këshilltarët e rrethit.

Procesverbalet do të përmbajnë:

a) Numërimin e qendrës së votimit dhe të zonës elektorale.

b) Kohën e fillimit dhe të përfundimit të votimit.

c) Numrin e zgjedhësve në listën e zgjedhësve.

d) Numrin e zgjedhësve në listën shtesë.

e) Numrin e votuesve sipas shënimeve të listës së zgjedhësve.

ë) Numrin e fletëve të votimit të vlefshme.

f) Numrin e fletëve të votimit të pavlefshme.

g) Numrin e fletëve të votimit të nxjerra jashtë përdorimit para votimit.

h) Numrin e fletëve të votimit të papërdorura.

i) Numrin e votave për çdo subjekt elektoral ose kandidat të pavarur për këshilltar komune ose bashkie.

j) Numrin e votave për çdo kandidat për kryetar të komunës ose bashkisë.

k) Numrin e votave për çdo subjekt elektoral ose kandidat të pavarur për këshilltar rrethi.

l) Numrin e kopjeve në të cilat është hartuar procesverbali.

ll) Vërejtjet e ndryshme të motivuara të anëtarëve dhe të vëzhguesve të veçantë dhe vendimet

e marra për to.

m) Të dhënat e pikave nga "c" deri në "l" jepen me shifra dhe fjalë.

Procesverbali firmoset nga kryetari dhe sekretari i komisionit të qendrës së votimit dhe duhet të përmbajë vulën përkatëse.

Çdo anëtar i komisionit të qendrës së votimit mund t'i firmosë procesverbalet. Mungesa e firmave të këtyre nuk i bën ato të pavlefshme. Anëtari i komisionit ka të drejtë të kërkojë të shënohen në procesverbal arsyet e mosfirmosjes nga ana e tij.

Procesverbali firmoset në çdo fletë. Çdo korrigjim eventual firmoset duke shënuar fjalën "korrigjim".

Çdo subjekt elektoral, si dhe shoqatat e specializuara për vëzhgimin e zgjedhjeve kanë të drejtë të marrin kopje të prcesverbalit.

Neni 77

Komisioni i qendrës së votimit i dërgon komisionit të zgjedhjeve të komunës ose bashkisë 2 kopje të procesverbalit me rezultatet e votimit, të mbajtur për këshillat e komunave ose bashkisë dhe dy kopje të procesverbalit të mbajtur për kryetarin e komunës ose bashkisë, së bashku me fletët e votimit, vulat dhe listat e zgjedhësve.

Komisioni i qendrës së votimit i dërgon komisionit të zgjedhjeve të rrethit një kopje të procesverbalit për zgjedhjen e këshillit të rrethit, së bashku me fletët e votimit përkatës.

Të gjitha këto materiale dorëzohen personalisht nga kryetari dhe sekretari i komisionit të qendrës së votimit, së bashku me cilindo nga përfaqësuesit e subjekteve elektorale që dëshiron, tshoqëruar me punonjës policie, brenda 24 orëve nga përfundimi i votimit.

Zarfet me fletët e votimit, vulat, listat e zgjedhësve dhe procesverbalet e komisioneve të qendave të votimit dorëzohen në rreth nga komisioni i zgjedhjeve të komunës apo bashkisë.

Neni 78

Komisionet e zgjedhjeve të komunës dhe bashkisë nxjerrin rezultatin e votimit mbi bazën e të dhënave të procesverbaleve të qendrave të votimit dhe i shpallin ato në formën e një procesverbali, i cili duhet të mbajë:

1. Numrin e qendrave të votimit.
2. Numri i zgjedhësve sipas listave të zgjedhësve.
3. Numrin e votuesve sipas shënimeve në lista.
4. Numrin e votuesve sipas fletëve të votimit të hedhura në kuti.
5. Numrin e votave të fituara nga çdo subjekt elektoral ose kandidat i pavarur në çdo qendër votimi.
6. Numrin e votave të fituara nga çdo kandidat për kryetarkomune ose bashkie në çdo qendër votimi.
7. Fletët e votimit të pavlefshme.
8. Numrin e vendeve për anëtar këshilli komune ose bashkie, që ka fituar çdo subjekt elektoral.
9. Emrin, atësinë dhe mbiemrin e kandidatëve që fitojnë.
10. Ankimet, vërejtjet dhe vendimet e marra për to.

Të dhënat në numrat 1 deri në 8 duhet të bëhen me shifra dhe fjalë.

Neni 79

Komisioni i zgjedhjeve të rrethit nxjerr rezultatin e votimit mbi bazën e të dhënave të procesverbaleve të qendrave të votimit dhe i shpall ato brenda tri ditëve në formën e një procesverbali, i cili duhet të përmbajë të dhënat e nenit 78 të këtij ligji, pikat 1, 2, 3, 4, 5, 7, 10, si dhe numrin e vendeve për anëtar të këshillit të rrethit që ka fituar çdo subjekt elektoral.

Neni 80

Numri i vendeve që i takojnë çdo subjekti elektoral caktohet në proporcion me numrin e votave të vlefshme që ka fituar. Votat e subjekteve që nuk arrijnë të fitojnë vend, ju shpërndahen proporcionalisht subjekteve që kanë fituar vende.

Vendet e fituara u jepen kandidatëve në bazë të renditjes që kanë në listat e paraqitura nga subjektet elektorale.

Neni 81

Për funksionin e kryetarit të komunës ose bashkisë fiton kandidati që në raundin e parë të zgjedhjeve ka marrë shumicën absolute të votave të vlefshme.

Në rast se asnjë prej kandidatëve nuk merr një shumicë të tillë, pas një jave bëhet një tjetër raund votimi ndërmjet kandidatëve që kanë fituar dy vendet e para. Kur për këto dy vende kanë fituar vota me numër të barabartë më shumë se dy kandidatë, mbeten dy që caktohen me short.

Në qoftë se një subjekt elektoral e tërheq kandidatin e vet nga raundi i dytë i zgjedhjeve, si kandidat zëvendësues paraqitet ai që ka përqindjen më të madhe të votave ndër kandidatët e tjerë që kanë marrë pjesë në raundin e parë të zgjedhjeve.

Shpallja e kandidatëve për raundin e dytë bëhet nga komisioni përkatës i zgjedhjeve.

Kandidati, i cili merr numrin më të madh të votave në raundin e dytë deklarohet i zgjedhur. Në rast se votat ndahen në mënyrë të barabartë ndërmjet kandidatëve, për zgjedhjen e kandidatit përdoret shorti.

Neni 82

Komisionet e zgjedhjeve të komunave, bashkive dhe rretheve i dërgojnë një kopje të procesverbalit të tyre Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 3 ditë pas përfundimit të votmeve.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shpall rezultatet përfundimtare në shkallë kombëtare brenda 5 ditëve pas ardhjes së dokumenteve nga komisionet e zgjedhjeve, të cilat botohen në një buletin të posaçëm.

KREU V
MARRJA FUND E MANDATIT TË KËSHILLTARIT
DHE KRYETARIT TË KOMUNËS OSE BASHKISË

Neni 83

Mandati i këshilltarit dhe kryetarit të komunës ose bashkisë merr fund para afatit në rastet e parashikuara në ligj.

Neni 84

Në rastet e mbarimit para afatit të mandatit të këshilltarit komisioni i mandateve të këshillit lokal shpall të zgjedhur kandidatin e radhës në listën që ka shpallur subjekti përkatës elektoral.

Në rastin kur këshilltari, të cilit i mbaron mandati, nuk përfaqëson një subjekt që ka lista, në zonën e tij kryhen zgjedhje brenda 45 ditëve. Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe kur mbaron para afatit mandati i kryetarit të komunës ose bashkisë.

Kur këshilltari merr përsipër një detyrë tjetër që nuk pajtohet me mandatin e tij, ai zëvëndësohet nga kandidati i radhës në listën përkatëse të subjektit elektoral.

KREU VI
DISPOZITA PENALE DHE ADMINISTRATIVE

Neni 85

Kushdo që për interes të tij ose të personave të tretë, ofron të holla, vende pune ose favore të tjera në cilëndo formë, për marrjen e firmës për paraqitjen e kandidatit, për votim pro ose kundra apo

për mospjesëmarrje në votim, dënohet me heqjen e lirisë nga 6 muaj deri në 3 vjet.

Këto dënime jepen edhe ndaj zgjedhësit që për kryerjen e veprimeve të mësipërme merr të holla ose përfiton vende pune a favore të tjera në çdo lloj forme.

Në të njëjtën mënyrë dënohen edhe ata që kërcënojnë apo shtrëngojnë zgjedhësin për kryerjen e veprimeve të mësipërme.

Neni 86

Kushdo që për interes të tij ose të personave të tretë, për të ndikuar në zgjedhje shpërndan në çdo lloj forme gjatë fushatës elektorale dhe ditën e votimit, të holla, sende konsumi ose dhurata të tjera, dënohet me heqje të lirisë nga 1 deri në 3 vjet.

Neni 87

Shkelja e rregullave të parashikuara në këtë ligj dënohet me gjobë nga 1000 deri në 5000 lekë, me përjashtim të rasteve kur shkelja e kryer përbën vepër penale.

Neni 88

Për shkeljen e dispozitave që kanë të bëjnë me ruajtjen dhe administrimin e rregullit të fletëve të votimit, listave të zgjedhësve, të kutive dhe të procesverbaleve të votimit, masa e gjobës rritet nga 5000 deri në 10.000 lekë, me përjashtim të rasteve kur shkelja përbën vepër penale.

Neni 89

Vendimet e dënimit me gjobë jepen nga komisionet e zgjedhjeve të komunave, bashkive dhe rretheve ose nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Vendimet e dënimit me gjobë, që kanë marrë formën e prerë janë tituj ekzekutivë.

KREU VII
DISPOZITA TRANZITORE DHE TË FUNDIT

Neni 90

Për zbatimin e këtij ligji, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve lëshon udhëzime të veçanta.

Neni 91

Vëzhgues të huaj në kuptim të këtij ligji, konsiderohen:

Përfaqësuesit parlamentarë të shteteve anëtare të KSBE, të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës, të Parlamentit Europian dhe të organizatave të tjera që lidhen me çështjen e tëdrejtave të njeriut.

Përfaqësuesit e partive dhe të lëvizjeve politike të huaja, si dhe individë të ftuar nga partitë dhe grupime partish.

Përfaqësues të autorizuar nga organizma të vendit e të huaj, të specializuar në fushën e zgjedhjeve.

Neni 92

Vëzhguesit e huaj, gazetarët dhe përfaqësuesit e mjeteve tëinformimit pajisen me autorizim të posaçëm nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Vëzhguesit që kanë autorizim nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kanë të drejtë të lëvizin lirisht në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe të ndjekin e të vëzhgojnë të gjithë veprimtaritë që bëhen, si gjatë fushatës elektorale, ashtu edhe ditën e votimit.Ata kanë të drejtë të pyesin, të mbledhin të dhëna e të japin publikisht mendime, duke qenë të paanshëm.

Neni 93

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për sigurimin e bazës materiale e financiare dhe për marrjen e masave organizative për zbatimin e këtij ligji.

Neni 94

Dekreti nr.4243, datë 13.3.1967 "Për zgjedhjet e këshillave popullorë dhe të gjykatave popullore", si dhe çdo dispozitë tjetër që vjen në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 95

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.227, datë 20.6.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha